



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 tetor 2023
Nr.ref.: RK 2278/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI142/22

Parashtrues

Edmond Hoxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.nr.24/2022] të Gjykatës
Supreme të 25 majit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Edmond Hoxha në cilësinë e aksionarit në N.T.SH "Elite" sh.p.k., nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Gazmend Nushi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.nr.24/2022] e 25 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ae.nr. 231/2021] e 26 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [I.EK.nr.297/20] e 9 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me te cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 shtator 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 26 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [GjR.KI142/22] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [KSH.KI142/22], caktoi anëtarët e kolegjit shqyrtues: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 8 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.

11. Më 30 gusht 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të N.T.Sh “Elite” sh.p.k (në tekstin e mëtejme: “Elite”), kishte lidhur një kontratë për partneritet publik – privat me disa nga Komunat e Kosovës për realizimin e projektit për fabrikimin dhe instalimin e elementeve të ndryshme urbane në territorin e tyre në vlerë prej 2,470,000.00 euro.
13. Më 21 prill 2010, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” me qëllim të realizimit të projektit të kontraktuar kishte lidhur kontratë me “Gekos” sh.p.k. (në tekstin e mëtejme: “Gekos”) për shitjen e aksioneve. Në përputhje me këtë kontratë, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” kishte transferuar të pala kontraktuese “Gekos” tetëdhjetë përqind (80%) të aksioneve të “Elite”, ndërsa 20 njëzet përqind (20%) të aksioneve kanë mbetur në pronësi të parashtruesit të kërkesës. Sipas kësaj kontrate, në realizimin e projektit të kontraktuar parashihej që investimi nga palët kontraktuese të bëhet në proporcion me pjesëmarrjen në aksione. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” kishte për detyrim që të investojë shumën prej 494,000.00 euro, ndërsa pala tjetër “Gekos” shumën prej 1,976,000.00 euro, në mënyrë që të realizohej projekti i kontraktuar në vlerë prej 2,470,000.00 euro.
14. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se “Gekos” kishte investuar shumën *“në vlerë prej 1,125.000.00 euro, duke bartur këtë shumë të parave në llogarinë bankare të parashtruesit të kërkesës në emër të blerjes së aksioneve, e cila shumë ka qenë e destinuar për realizimin e projektit të kontraktuar nga parashtruesi i kërkesës.”*
15. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se sipas kontratës së lidhur, parashihej që mjetet që i paguan “Gekos” në emër të çmimit për blerjen e aksioneve, parashtruesi i kërkesës, duhej t’i investojë në projektin e kontraktuar sipas kontratës publike. Në realizimin e projektit të kontraktuar, parashtruesi i kërkesës kishte *“investuar shumën totale prej 849,000.00 euro, pra nga shuma prej 1,125,000.00 që kishte paguar “Gekos” vetëm shuma prej 849,00.00 euro kishte shkuar në investime”* për realizimin e projektit të kontraktuar, *“ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 276,00.00 euro është përvetësuar nga paditësi si pronë personale në kundërshtim me kontratën e lidhur.”*
16. Më 23 shkurt 2012, si rezultat i situatës së krijuar si më lart, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” dhe “Gekos” lidhen një aneks kontratë përmes së cilës konstatuan se vlera e investuar në realizimin e projektit të kontraktuar nga parashtruesi i kërkesës është me vogël se shuma që ishte paguar/investuar nga “Gekos”. Si rezultat i kësaj, palët u dakorduan që “Gekos” në cilësinë e palës kontraktuese në realizimin e projektit të kontraktuar *“nuk do të vazhdojë me investime tjera, përderisa vlera e aseteve në terren të mos arrijë shumën prej 1,125.000.00 euro, shumë kjo e investuar fillimisht nga “Gekos”.* Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” nuk kishte vazhduar me investimin e mjeteve të pranuar nga “Gekos”, duke shkelur kështu detyrimet që rrjedhin nga aneksi kontrata e lidhur mes tyre. Meqenëse, palët kanë konstatuar me aneks kontrate se parashtruesi i kërkesës ka dështuar që shumën prej 1,125.000.00 euro, ta shpenzojë për nevojat e projektit, palët kanë pezulluar detyrimin e pagimit të këstit të dytë prej 851,000.00 euro deri në shpenzimin e pjesës së parë për nevojat e projektit. Meqë pjesa e parë e mjeteve financiare nuk ka vazhduar të investohet me tutje në projekt, kjo për pasojë ka rezultuar edhe mosplotësimin e kushtit kontraktues për investimin e pjesës së dytë nga “Gekos”.

17. Më 26 maj 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër "Gekos" për shkak të mospërbushjes së kontratës, ku kërkoi 851,000.00 euro, me kamatë prej 8%, në emër të përbushjes së obligimit nga kontrata për shitblerjen e aksioneve.
18. Më 3 tetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.Ek.nr.312/14] refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke vendosur si në vijim:
- I. *Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Edmond Hoxha nga Gjakova, aksionar në N.T.SH. "Elite", sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri "Gekos" sh.p.k, me seli në Prishtinë, që në emër të përbushjes së detyrimit kontraktues nga kontrata për shitblerjen dhe bartjen e aksioneve, paditësit t'ia paguaj shumën prej 851,000.00 €, me kamatë prej 8% në vit, e cila fillon të rrjedhë nga data 01.01.2013 deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.*
 - II. *Detyrohet paditësi, që të paditurit t'ia paguajë shumën prej 747.50 € në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.*
19. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.Ek.nr.312/14] të 3 tetorit 2019 sqaroi se "Në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratë të dyanshme detyruese, ku detyrimi i të paditurit ka qenë i varur nga përbushja paraprake e detyrimit të paditësit. Meqenëse paditësi ka dështuar në përbushjen e detyrimeve të tij, nuk ka respektuar se ku i ka shpenzuar mjetet financiare të destinuara ekskluzivisht për realizimin projektit, rezulton se nuk janë krijuar kushtet ligjore dhe kontraktuese për përbushjen e detyrimeve nga i padituri e rrjedhimisht nuk është shkaktuar asnjë lloj dëmi tek pala paditëse."
20. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe rasti të kthehet në rivendosje.
21. Në një datë të paspecifikuar, "Gekos" kishte paraqitur përgjigje në ankesë me propozimin që të vërtetohet Aktgjykimi [I.Ek.nr.312/14] i Gjykatës Themelore i 3 tetorit 2019.
22. Më 11 qershor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.284/2018] vendosi që të "APROVOHET ankesa e paditësit Edmond Hoxha nga Gjakova, aksionar në N.T.SH "Elite", ndërsa të PRISHET Aktgjykimi I.EK.nr312/14 i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike i datës 03.10.2018, dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim dhe rivendosje."
23. Gjykata e Apelit përmes të njëjtit Aktvendim sqaroi se Aktgjykimi [I.Ek.nr.312/14] i Gjykatës Themelore i 3 tetorit 2019 "është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas neneve 182 par. 1 dhe 182 par. 2, pika n) për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare mes asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës."

24. Më 9 gusht 2021, Gjykata Themelore në rigjykim nxori Aktgjykimin [I.EK.nr.297/20] dhe vendosi si në vijim:
- I. *Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Edmond Hoxha nga Gjakova, aksionar në N.T.SH. "Elite", sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri "Gekos" sh.p.k, me seli në Prishtinë, që në emër të përmbushjes së detyrimit kontraktues nga kontrata për shitblerjen dhe bartjen e aksioneve, paditësit t'ia paguajë shumën prej 851,000.00€, me kamate prej 8% ne vit, e cila fillon të rrjedhë nga data 01.01.2013 deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.*
 - II. *Detyrohet paditësi që të paditurit t'ia paguajë shumën prej 3,185.00 € në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.*
25. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.297/20] duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 17 dhe paragrafin 1 të nenit 262 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, sqaroi se *"paditësi nuk i ka përmbushë investimet e kërkuara me kontratë dhe aneks kontratë, si kusht për krijimin detyrimit të të paditurit që të paguajë pjesën e mbetur të investimit prej 851,000,00 €. Fryma e kontratës dhe aneks kontratës ka qenë që mjetet e paditësit të përdoren për prodhim dhe vendosje të aseteve. Kjo është e drejtë dhe logjike, sepse blerja e aksioneve ka kuptimin vetëm nëse aksionet janë të shprehura në asete, në rastin konkret në asetet e përshkruara në kontratë. Për këtë arsye, edhe aneks kontrata ka paraparë që "Kiosqet, Billbordat, Citylights, Mbishtyllat, do të referohen bashkërisht si asete".*
26. Më 16 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe rasti të kthehet në rivendosje.
27. Më 26 nëntor 2021, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [I.EK.nr.297/20] të 9 gushtit 2021 me arsyetimin se nuk ishte i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 2 i nenit 182, si dhe gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të rregullt dhe e drejta materiale është zbatuar drejt.
28. Gjykata e Apelit duke iu referuar neneve 75, 86 dhe 98 të Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 vlerësoi se *"paditësi nuk ka pasur kapital e as aksioni mbi bazën kontratës për partneritetin publiko privat me Komunat e Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht me kontratën e datës 21 prill 2010, nuk ka mundur të shesë aksionet të cilat nuk i ka pasur por ka kërkuar kapital shtesë përmes investimit të së paditurit, i cili investim përben rritje të kapitalit të shoqërisë dhe pronësi të së paditurit mbi aksionet e shoqërisë në bazë të kapitalit të rritur të shoqërisë. Çdo tërheqje e kapitalit të shoqërisë nga paditësi për nevoja vetanake bie në kundërshtim me dispozitatat ligjore të sipërcituara".*
29. Më 21 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 i Ligjit për Procedurën Kontestimore si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përmes revizionit ndërli dhej me zbatimin e ligjit të gabuar në rrethanat e rastit të tij, përkatësisht zbatimi i Ligjit [Nr.06/L-016] për

Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 dhe Ligjit [Nr.04/L-077] për Marrëdhëniet e Detyrimeve të 19 qershorit 2012 nga gjykatat e rregullta gjatë vendosjes së rastit të tij. Parashtruesi argumentoi se zbatimi i ligjeve të lartpërmendura në rastin e tij përbën zbatim të gabuar sepse marrëdhënia detyrimore kishte lindur në vitin 2010, ndërsa ligjet e zbatuara në rastin e tij kanë hyrë në fuqi pas krijimit të marrëdhënies së tij kontraktuale.

30. Më 25 maj 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.24/2022] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë respektuar LPK-në për përmbajtjen dhe strukturën e aktgjykimit dhe se aktgjykimi i shkallës së dytë *“ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare. Ai përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
32. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë zbatuar ligjet e gabuara në rrethanat e rastit të tij, respektivisht në rastin e tij janë zbatuar ligjet të cilat nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënie kontraktuale mes palëve.
33. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike pretendon se Gjykata e Apelit në nxjerrjen e Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] të 26 nëntorit 2021 *“ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr. 06/L-016 i cili ka hyrë në fuqi tek më datën 24 maj 2018. Ky ligj fare nuk ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve kontraktuale mes parashtruesit të kërkesës dhe Gekos në vitin 2010”*.
34. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës argumenton se *“në kohën e themelimit të detyrimeve kontraktuale mes parashtruesit të kërkesës dhe Gekos, në fuqi ka qenë Ligji për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123 i shpallur në Gazetën Zyrtare më datën 1 Tetor 2008 dhe i cili është shfuqizuar më 24 maj 2018 kur ka hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-016”*.
35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se refuzimi i pretendimit të tij nga Gjykata Supreme lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit gjatë vendosjes së rastit të tij në Gjykatën e Apelit, përbën shkelje të së drejtës së tij për *“gjykim të drejtë”* dhe të parimit të sigurisë juridike.
36. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson *“Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi lidhur me pretendimin se Gjykata e Apelit gabimisht zbatoi të drejtën materiale, Gjykata Supreme e konfirmon këtë shkelje duke potencuar se “... pajtohet në parim se asnjë ligj nuk mund të ketë ndikim retroaktiv, mirëpo zbatimi i disa dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr. 06/L-016 nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme nuk i konsideron me ndikim vendimtar ...”*.
37. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme e ka krijuar një precedent antikushtetues dhe antiligjor duke e legalizuar të drejtën e një gjykate që në zgjidhjen e kontestit, mund t'i zbatojë edhe dispozitat ligjore të cilat fare nuk kanë qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të raporteve juridike-detyrimore”*.

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme ia kanë mohuar të drejtën e garantuar për gjykim të drejtë e cila, mes tjerash, nënkupton se zgjidhja e një kontesti bëhet sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporteve juridike-detyrimore dhe shkaktimit të kontestit, e jo me legjislacionin i cili fare nuk ka qenë në fuqi në atë kohë dhe i cili ka hyrë në fuqi plot 8 (tetë) vite pas krijimit të këtyre raporteve dhe pas shkaktimit të kontestit”.
39. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se “me zbatimin arbitrar të së drejtës inekzistente materiale, këto dy Gjykata objektivisht e kanë mohuar parimin e shtetit ligjor duke u rreshtuar në kundërshtim me qëndrimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas të cilës arbitrariteti është njësoj sikur mohimi i shtetit ligjor”.
40. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tij i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) në rastet *Beian kundër Rumanisë* (Aktgjykim i 6 dhjetorit 2008) dhe *Al-Dulimi i Montana Management kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 21 qershorit 2016).

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i 30 marsit 1978

Detyrat e përmbushjes së detyrimit

Neni 17

Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij. Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhënien e detyrimit ose në bazë të ligjit.

Përmbushja e detyrimit dhe pasojat e mospërmbushjes

Neni 262

Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbytja e tij.

Kur debitori nuk e përmush detyrimin ose vonon me përmbytjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak.

Për dëmin për shkak të vonesës të përmbytjes së detyrimit përgjigjet edhe debitori të cilit kreditori ia ka dhënë afatin e ri plotësues për përmbytjen e detyrimit.

Debitori përgjigjet edhe për pamundësinë e pjeshme apo të plotë të përmbytjes megjithëse për këtë pamundësi nuk ka faj nëse ka lindur pas vonesës së tij, për të cilën përgjigjet.

Mirëpo, debitori shkarkohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se provohet se sendi që është objekti i detyrimit është shkatërruar rastësisht dhe se ai detyrimin e vet e ka përmbytur në kohë.

Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare i 24 Majit 2018

Neni 75

Natyra e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit

1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve.

2. Aksionet në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar janë njësitë në bazë të të cilave bëhet ndarja e pronësisë në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar.

3. Një aksion në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar është pronë personale e aksionarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë ligj dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Statut.

4. Në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund, por nuk është e detyrueshme, të parashihet që aksionet të dëshmohen përmes certifikatave të lëshuara nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 86

Përgjegjësia për Kontributet e Dakorduara

Aksionari është i detyruar që Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar t'ia paguajë të gjitha kontributet me afat, sipas Statutit apo Marrëveshjes së Inkorporimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër të Aksionarëve. Ky detyrim nuk mund të arsyetohet për shkak të vdekjes, paaftësisimit, ose paaftësisë tjetër për pagim të Aksionarit

Neni 98

Blerja e Aksioneve të Veta nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar

[...]

Aksionet që mbahen në thesarin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar:

5.1. nuk kanë kurrfarë të drejte të votës;

5.2. nuk numërohen për çfarëdo qëllimi, duke përfshirë gjatë përcaktimit të kuorumit ose përcaktimit të numrit të aksioneve të papaguara ose Aksioneve me të drejtë vote; dhe

5.3. nuk kanë të drejtë, dhe nuk marrin pjesë në shpërndarjet e dividendëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

43. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë

Neni 47 i Ligjit [Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48 i Ligjit [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 i Ligjit [Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

44. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E.Rev.24/2022] e Gjykatës Supreme të 25 majit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
45. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së Punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së Punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 34 (2) në mënyrë specifike përcakton që:

*Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)*

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

46. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së Punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese Nexhmije Makolli, Aktvendimi për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, dhe [KI175/20](#), parashtruese Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
47. Në këtë kontekst dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese në rrethanat e këtij rasti, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 39).
48. Gjykata vëren se çështja e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar përmes pesë (5) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.Ek.nr.312/14] të 3 tetorit 2019, e cila refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për pagesën e shumës prej 851,000.00 euro nga "Gekos", me kamatë prej 8% në emër të përmbushjes së obligimit nga kontrata e 21 prillit 2010, me arsyetimin se nuk janë krijuar kushtet ligjore dhe kontraktuale për përmbushjen e detyrimit nga "Gekos" dhe se nuk është shkaktuar asnjë lloj dëmi tek parashtruesi i kërkesës. Pas ankimit, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.284/2018] të 11 qershorit 2020 anuloi Aktgjykimin [I.Ek.nr.312/14] e Gjykatës Themelore me arsyetimin se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe se janë shkelur dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe rrjedhimisht ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore. Në procedurën e rigjykimit, Gjykata Themelore përmes

Aktgjykimit [I.EK.nr.297/20], duke u bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës meqë ky i fundit nuk e kishte përmbushur detyrimin, përkatësisht investimet e kërkuara me kontratën e 21 prillit 2010 dhe aneks kontratën si kusht për krijimin e detyrimit të “Gekos” që të paguajë pjesën tjetër të detyrimit, përkatësisht shumën prej 851,000,00 euro. Ky Aktgjykimi ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] duke vlerësuar se drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë ishte zbatuar e drejta materiale në rrethanat e rastit konkrete nga Gjykata Themelore dhe se nuk kishte shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke konfirmuar kështu në tërësi përfundimet e arritura dhe bazën ligjore të aplikuar nga Gjykata Themelore. Gjykata e Apelit përveç që konfirmoi bazën ligjore të aplikuar nga Gjykata Themelore, ajo përgjatë arsytimit të rastit u referua në dispozitat përkatëse të Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018, ku në esencë vlerësoi se parashtruesi i kërkesës kishte dështuar të përmbushet detyrimet nga marrëdhënia kontraktuale me “Gekos” dhe se *“çdo tërheqje e kapitalit të shoqërisë nga paditësi [parashtruesi i kërkesës] për nevoja vetanake bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara”*.

49. Parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion kundër Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme duke pretenduar në esencë zbatim të gabuar të ligjit, respektivisht zbatim të ligjeve në rrethanat e rastit të tij të cilat nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënie kontraktuale mes palëve, respektivisht sipas tij zbatimi i gabuar i ligjit në rastin e tij konsiston në zbatimin e Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 dhe Ligjit [Nr.04/L-077] për Marrëdhëniet e Detyrimeve të 19 qershorit 2012, ndërsa krijimi i marrëdhënieve detyimore mes palëve ishte krijuar në vitin 2010.
50. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.24/2022] të 25 majit 2022 refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se aktgjykimi i kontestuar nuk përmban shkelje të dispozitave procedural në kuptim të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Gjykata Supreme gjithashtu konfirmoi si të drejtë referencën e Gjykatës së Apelit në Ligjin [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 dhe veçanërisht zbatimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 në rastin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme gjithashtu vlerësoi se parashtruesi kishte dështuar që të përmbushë detyrimet e tij sipas kontratës së lidhur, respektivisht nuk kishte përmbushura investimet e kërkuara me kontratë dhe aneks kontratë si kusht për krijimin e detyrimit të palës tjetër “Gekos” që të paguajë pjesën e mbetur të investimit në vlerë prej 851,000,00 euro.
51. Konstatimet e gjykatave të rregullta dhe në mënyrë specifike konstatimet e Gjykatës Supreme, parashtruesi i konteston para Gjykatës duke pretenduar se Aktgjykimi [E.Rev.nr.24/2022] i 25 majit 2022 është nxjerr në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
52. Gjykata vëren se pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës në thelb kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke pretenduar në esencë zbatimin e gabuar të ligjit gjatë tërë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e rregullta. Në mënyrë specifike, parashtruesi i kërkesës pretendon se zbatimi i Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 dhe Ligjit [Nr.04/L-077] për Marrëdhëniet e Detyrimeve të 19 qershorit 2012 përben shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht shkelje të parimit të sigurisë juridike sepse ligjet e sipërcituara nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënies detyimore mes palëve me rastin e nënshkrimit të kontratës së 21 prillit 2010.
53. Gjykata vëren se gjatë tërë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e rregullta, çështja kryesore ishte përmbushja e detyrimeve kontraktuale mes palëve që rridhnin nga kontrata e 21 prillit 2010, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës në cilësinë e

aksionarit të “Elite” kishte investuar shumë e pranuar nga “Gekos” në vlerë prej 1,125.000.00 euro, çështje kjo e cila përmes aneks kontratës të 23 shkurtit 2012 ishte konstatuar se vlera e investuar nga parashtruesi ishte me e vogël se vlera e paguar nga “Gekos”.

54. Në lidhje me këtë çështje dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vë në dukje se gjykatat e rregullta kanë trajtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar.
55. Në këtë kontekst, dhe në veçanti lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.297/20] të 9 gushtit 2021, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

“Nga ekspertiza gjyqësore e pranuar nga R.F., gjykata ka gjetur se paditësi ka investuar në produkte në shumën totale 849,000.00 €. Kjo paraqet shkelje drastike të kontratës nga ana e tij. Pra, nga shuma prej 1,125,000.00 € që kishte paguar i padituri, vetëm shuma prej 849,000.00 € kishte shkuar në investime, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 276,000.00 € është përvetësuar nga paditësi, si pronë personale, në kundërshtim me kontratën e lidhur.

[...]

“Me dispozitat e nenit 17.1. të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë të zbatojnë detyrimin e veta dhe janë përgjegjëse për përmbushjen e tyre. Ndërsa me dispozitat e nenit 262 par.1 të LMD-së është përcaktuar se kreditori në raportin detyrimor është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin në mënyrë të ndërgjegjshme. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kontrate të dyanshme detyruese, ku detyrim i të paditurit ka qenë i varur nga përmbushja paraprake e detyrimit të paditësit”

“Siç është theksuar edhe me sipër në këtë aktgjykim, paditësi nuk i ka përmbushur investimet e kërkuara me kontratë dhe aneks kontratë, si kusht për krijimin detyrimit të së paditurit që të paguajë pjesën e mbetur të investimit prej 851,000,00 €. Fryma e kontratës dhe aneks kontratës ka qenë që mjetet e paditësit të përdoren për prodhim dhe vendosje të aseteve. Kjo është e drejtë dhe logjike, sepse blerja e aksioneve ka kuptimin vetëm nëse aksionet janë të shprehura në asete, në rastin konkret në asetet e përshkruara në kontratë [...]”

56. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ae.nr.231/2021] të 26 nëntorit 2021, në kontekst të pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

[...] gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij, nuk ka arsyetuar se ku i ka shpenzuar mjetet financiare të paguara nga i padituri dhe të destinuara ekskluzivisht për realizimin e projektit andaj nuk janë krijuar kushtet ligjore dhe kontraktuese për përmbushjen e detyrimeve nga i padituri”

57. Gjykata e Apelit në vazhdim duke iu referuar në mënyrë specifike paragrafit 2 të nenit 75 [Natyra e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit]; nenit 86 [Përgjegjësia për Kontributet e Dakorduara] dhe paragrafi 5 të nenit 98 [Blerja e Aksioneve të Veta nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar] të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018, arsyetoi si në vijim:

[...] aksionet nuk përbejnë të drejtë autonome apo vlerë në vete, por janë pasqyrim i pronësisë mbi kapitalin apo asetet e shoqërisë. Shoqëria ka aksione po aq sa ka kapital respektivisht vlera nominale e aksioneve paraqet vlerën e kapitalit të shoqërisë. Madje shoqëria ka detyrim ligjor që në rastet kur numri i aksioneve dhe vlera e tyre nuk përputhet me numrin real të shoqërisë, ta zvogëloj kapitalin themeltare dhe në përputhje me këtë ta reduktoj numrin e aksioneve apo ta zvogëloj vlerën nominale të aksioneve, sepse është e palejueshëm që shoqëria të këtë aksione të emetuara pa mbulose të kapitalit”

[...]

Në rastin konkret me kontratën e datës se 21 prillit 2010, aksionarët janë pajtuar për kontribute shtesë në rritjen e kapitalit të shoqërisë, sipas proporcionit 89% me 20%. Këto investime të dakorduara përbejnë obligime ligjore të aksionarëve ndaj shoqërisë, të cilat duhet të përmbushën dhe aksionet e shitura të paditurit përbejnë aksione të paguara me kufizime të përcaktuara me nenin 98. par. 5 të LTSH-së.

[...]

Paditësi nuk ka pasur kapital e as aksione mbi bazën kontratës për partneritetin publiko private me Komunat e Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht me kontratën e datës së 21 prillit 2010, nuk ka mundur të shesë aksione të cilat nuk i ka pasur, por ka kërkuara kapital shtesë përmes investimit të së paditurit, i cili investim përben rritje të kapitalit të shoqërisë dhe pronësisë të së paditurit mbi aksionet e shoqërisë në bazë të kapitalit të rritur të shoqërisë. Çdo tërheqje e kapitalit të shoqërisë nga paditësi për nevoja vetanke, bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.”

58. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.24/2022] të 25 majit 2022, duke iu referuar gjendjes faktike në rastit të parashtruesit të kërkesës, kishte sqaruar si në vijim:

“Në një gjendja të tillë faktike, Gjykata Supreme pranon si të bazuar qëndrimin juridike të dy gjykate të sipërpërmendura lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit, nga se aktgjykimet e tyre në këtë çështje kontestimore nuk janë përfshirë me asnjë lloj shkelje thelbësore dhe procedurale, e as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat gjykatat e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-kujdeset sipas detyrës zyrtare.

[...]

“Në këtë kontekst janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.”

[...]

Edhe kontrata bazë ka qenë strikte në vendosjen e përgjegjësisë për paditësin që mjetet e paguara nga paditësi t'i investojë në asete. Madje ka paraparë edhe sanksione, respektivisht humbje të aksioneve të paditësit deri në humbjen e plotë të tyre, nëse ai mjetet e paguara nga paditësi, nuk i konverton në investime me aneks kontratë, se paditësi ka dështuar që shumen prej 1,125.000.00 € ta

shpenzojë për nevoja të projektit, ka pezulluar detyrimin e pagimit të këstit të dytë prej 851,000.00 €, ta shpenzojë për nevoja të projektit. Mirëpo, kësti i parë nuk ka vazhduar të investohet me tutje në projekt, gjë që ka pasur për pasojë edhe mosplotësimin e kushtit kontraktuese për investimin e këstit të dytë nga i padituri”

[...]

Paditësi ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij, nuk ka arsytuar se ku i ka shpenzuar mjetet financiare të paguara nga i padituri dhe të destinuara ekskluzivisht për realizimin e projektit, edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rezulton se nuk janë krijuar kushtet ligjore dhe kontraktuese për përmbushjen e detyrimeve nga i padituri”.

59. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se të gjitha gjykatat e rregullta në rrethanat e rastit konkret kishin trajtuar dhe arsytuar në mënyrë të detajuar çështjet e kontestuar dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
60. Të njëjtat, duke iu referuar gjendjes faktike të vërtetuar në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ndërlidhura kryesisht me vërtetimin e gjendjes faktike, dhe kishin sqaruar se **(i)** kontrata e 21 prillit 2010 e lidhur mes parashtruesit të kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” dhe palës tjetër “Gekos” detyronte parashtruesin që për qellim të realizimit të projektit të kontraktuar të investojë shumën prej 494,000, 00 euro dhe “Gekos” të investojë shumën prej 1,976,000.00 euro, të cilin detyrim kontraktual “Gekos” e kishte përmbushur duke bartur mjete financiare në vlerë prej 1,125,000.00 euro tek parashtruesi i kërkesës me qellim të realizimit të projektit të kontraktuar nga parashtruesi i kërkesës, por ky i fundit në cilësinë e aksionarit të “Elite” nga shuma e pranuar nga “Gekos”, pra nga shuma prej 1,125,000.00 euro, kishte investuar vetëm 849,000.00 euro, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 276,00.00 euro, është përvetësuar nga parashtruesi i kërkesës, si pronë personale në kundërshtim me kontratën e lidhur; **(ii)** ndërsa përmes aneks kontratës se 23 shkurtit 2012 e lidhur mes parashtruesit të kërkesës në cilësinë e aksionarit të “Elite” dhe palës tjetër “Gekos” përcaktohej se “Gekos” në cilësinë e palës kontraktuese nuk do të vazhdojë me investime tjera, respektivisht me investimin e pjesës së dytë në vlerë prej 851,000.00 euro, përderisa vlera/pjesa e parë (1,125,000.00 euro) e investuar fillimisht nga “Gekos” të shfrytëzohet në tërësi në realizimin e projektit të kontraktuar nga parashtruesi i kërkesës.
61. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në trajtim të pretendimeve të ngritura përmes ankesës së tij, respektivisht lidhur me pretendimin për përmbushjen e detyrimit nga “Gekos”, kishin sqaruar se (i) parashtruesi i kërkesës nuk kishte përmbushur investimet e kërkuara nga marrëdhënia kontraktuale e lidhur mes tij dhe “Gekos”; (ii) parashtruesi i kërkesës kishte investuar vetëm gjysmën e mjeteve financiare të pranuar nga “Gekos” në realizimin e projektit të kontraktuar; (iii) rezultati i mos investimit të vlerës fillestare të pranuar nga “Gekos” nga ana e parashtruesit të kërkesës në realizimin projektit të kontraktuar kishte për pasojë pezullimin e detyrimit të “Gekos” që të paguajë pjesën e dytë të mjeteve financiare në vlerë prej 851,000.00 euro; (iv) parashtruesi i kërkesës kishte dështuar që të plotësonte kushtin kontraktual për përmbushjen e detyrimit tjetër nga pala kontraktuese “Gekos”.
62. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në vlerësimet e tyre përfundimtare janë mbështetur në një administrimi të kujdesshëm të provave. Këto prova përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kontratën e 21 prillit 2010, aneksin e kontratës të 23 shkurt 2012 si dhe ekspertizën gjyqësore financiare të përgatitur nga eksperti A.G., së bashku me dy plotësimet e saj, dhe provat e bashkangjitura nga ekspertiza gjyqësore financiare të punuara nga eksperti gjyqësor R.F.

63. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në rastin e parashtruesit të kërkesës kishin analizuar gjerësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga palët në procedurë, dhe në fund kishin refuzuar ankesën duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 dhe Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018, që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
64. Në këtë kontekst, Gjykata sjell në vëmendje pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykatat e rregullta gjatë shqyrtimit dhe vendosjes së rastit të tij.
65. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon në esencë zbatim të ligjeve në rrethanat e rastit të tij të cilat nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënie kontraktuale mes palëve, respektivisht sipas tij zbatimi i gabuar i ligjit në rastin e tij konsiston në zbatimin e Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 nga ana e Gjykatës se Apelit dhe sipas parashtruesit të kërkesës edhe zbatimin e Ligjit [Nr.04/L-077] për Marrëdhëniet e Detyrimeve të 19 qershorit 2012, ndërsa krijimi i marrëdhënieve detyrimore mes palëve ishte krijuar në vitin 2010.
66. Në këtë aspekt, Gjykata vë në dukje se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.297/20] të 9 gushtit 2021, duke iu referuar në mënyrë specifike nenit 17 [Detyrat e përmbushjes së detyrimit] dhe nenin 262 [Përmbushja e detyrimit dhe pasojat e mospërmbushjes] të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, erdhi në përfundim se *“paditësi [parashtruesi i kërkesës] nuk i ka përmbushur investimet e kërkuara me kontratë dhe aneks kontrate, si kusht për krijimin detyrimit të së paditurit [“Gekos”] që të paguajë pjesën e mbetur të investimit prej 851,000,00 €”*.
67. Gjykata vë në dukje se baza ligjore e cekur më lart dhe, si rezultat, e zbatuar nga Gjykata Themelore, është konfirmuar në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, si ligji i aplikueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me përmbushjen e detyrimeve nga marrëdhënia kontraktuale ndërmjet tij dhe “Gekos”.
68. Gjykata nuk mund të mos vërej se Gjykata e Apelit përveç që kishte konfirmuar si të drejtë zbatueshmërinë e dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, ajo ju kishte referuar edhe dispozitave të Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018, i cili nuk ishte në fuqi në kohën kur ishte krijuar marrëdhënia kontraktuale mes palëve në fjalë.
69. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.24/2022] në trajtim të këtij pretendimi specifik të parashtruesit të kërkesës, kishte sqaruar si në vijim:

“Gjykata Supreme pajtohet se në parim asnjë ligj nuk mund të këtë efekt retroaktiv/prapaveprues, mirëpo zbatimin e disa dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr.06/L-016 i publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr.9 me datën 24.05.2018 nga ana e gjykatës se shkallës së dytë, Gjykata Supreme nuk e konsideron me ndikim vendimtar në vendosje ndryshe sipas kërkesëpadisë së paditësit, nga se, mënyra e vendosjes nga ana e gjykatës se shkallës së parë, me të drejtë e konfirmuar si e drejtë nga ana e gjykatës se shkallës së dytë, nuk bie ndesh as me dispozitat ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 02/L-123 i cili ishte në fuqi në vitin 2010 kur në mes palëve në këtë procedurë është lidhur kontratë mbi shitblerjen dhe bartjen e aksioneve të kompanisë. “Elite” sh.p.k – këtu paditësit”

70. Për me tepër, Gjykata Supreme duke iu referuar bazës ligjore të zbatuar në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës kishte sqaruar se *“me ndikim vendimtar në mënyrën e vendosjes është zbatimi i neneve 17.1 dhe 262.1 ët LMD-së, që ishte në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, nga se në këtë kontratë detyrimi i të paditurit ka qenë i varur nga përmbushja paraprake e detyrimit të paditësit. Paditësi nuk ka përmbushur detyrimin e investimeve të kërkuara me kontratë dhe aneks kontratë, si kusht për krijimin e detyrimit të paditurit që të paguajë pjesën e mbetur të investimit prej 851,000,00 €.”*
71. Gjykata vëren se përgjatë procesit gjyqësor të vendosjes se rastit të parashtruesit të kërkesës të zhvilluar në gjykatat e rregullta, këto të fundit nuk kanë bazuar vendimmarrjen e tyre vetëm duke iu referuar Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 por duke zbatuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret. Për me tepër, Gjykata vë në dukje se bazat ligjore të aplikuar në këtë rast, siç janë neni 17 [Detyrat e përmbushjes së detyrimit] dhe neni 262 [Përmbushja e detyrimit dhe pasojat e mospërmbushjes] të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, janë konfirmuar në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme si ligj i aplikueshëm në këto rrethana të rastit të parashtruesit të kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga marrëdhënia kontraktuale mes parashtruesit të kërkesës dhe “Gekos”.
72. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i zbatuar në rastin e tij është i vitit 2012, dhe rrjedhimisht nuk ka efekt juridik në zgjidhjen e rastit të tij.
73. Në këtë aspekt, Gjykata vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës Supreme e cila përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.24/2022] sqaroi se *“ani pse gjykata e shkalles së parë në aktgjykimin e saj nuk ka precizuar se këto dy dispozita ligjore janë të LMD të vjetër e jo të LMD të Kosovës, Gjykata Supreme gjen se këto dy dispozita ligjore janë të LMD të vjetër i cili ishte në fuqi deri në fund të vitit 2012”*.
74. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta përgjatë shqyrtimit të rastit të parashtruesit kishin sqaruar se: (i) dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 ishin të aplikueshme dhe ishin zbatuar në rrethanat e rastit konkret; (ii) referenca në përmbajtjen e Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 nuk ishte përcaktuese meqë përmbajtja e këtij ligji nuk ishte në kundërshtim me Ligjin [02/L-123] për Shoqëritë Tregtare të 1 tetorit 2008.
75. Gjykata vëren se referimi i Gjykatës së Apelit në dispozitat e Ligjit [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 ka shkaktuar konfuzion dhe pasiguri të parashtruesi i kërkesës lidhur me zbatueshmërinë e ligjit të duhur në rrethanat e rastit të tij, pasi ai argumenton se zbatimi i ligjit të sipërcituar nuk ishte i zbatueshme meqë kishte hyr në fuqi pasi ishte krijuar marrëdhënia e tij kontraktuale në fjalë. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se referenca në Ligjin [Nr.06/L-016] për Shoqëritë Tregtare të 24 majit 2018 ka qenë me peshë vendimtare që do të mund të ndikonte që të arrihej një rezultat ndryshe nëse ky ligj nuk do të aplikohej në rastin e tij.
76. Gjykata dëshiron të theksojë se në nivel të përgjithshëm, zbatimi i ligjeve që nuk janë të aplikueshëm në rastet e caktuara nuk përputhet me një praktikë të konsoliduar ligjore në aspektin e rigozitetit juridik, megjithatë në këtë rast, veprimi i Gjykatës së Apelit nuk duket të këtë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e parashtruar. Megjithatë, vlen të nënvizohet rëndësia e një vlerësimi me të hollësishëm të këtij fakti nga ana e Gjykatës së Apelit gjatë vendimmarrjes së saj.

77. Gjykata nënvizon se sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit kryesisht i takon gjykatave të rregullta të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislationit (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Perez kundër Francës, kërkesa nr. 47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 82) e jo Gjykatën, roli i së cilës është të verifikojë nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Kushtetutën (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, kërkesa nr. 13279/05](#), Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 49). Duke qenë kështu, me përjashtim të rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës të vejë në dyshim interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta. Megjithatë, në rastet të jashtëzakonshme, Gjykata mund të nxjerrë përfundimet e duhura kur gjykatat e rregullta kanë interpretuar ligjin në një mënyrë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme.
78. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se nuk mund të spekulojë lidhur me kushtetutshmërinë e procedurave të zhvilluara në gjykatat e rregullta sa i përket zbatueshmërisë së një ligji të caktuar në vend të një tjetri, sidomos, kur merret parasysh se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë dhënë shpjegime të detajuara dhe të arsyetuara nga gjykatat e rregullta lidhur me detyrimet kontraktuale mes palëve. Për të vlerësuar korrektësinë e zbatueshmërisë së një ligji në vend të një ligji tjetër në rrethanat e rastit konkret, Gjykatës i nevojiten “shkaqe me peshë” (*weighty reasons*), çka mungojnë në rrethanat e rastit konkret (shih rastin e Gjykatës [KI107/22](#) parashtrues *Valdet Avdiu*, cituar më lart, paragrafi 44).
79. Gjykata ka thënë gjithmonë se në përgjithësi nuk është detyra e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohet se janë kryer nga një gjykatë e rregullt, përveç nëse dhe për aq sa këto gabime janë të dukshme dhe kanë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (shih, në lidhje me doktrinën e “*shkallës së katërt*”, rastin e GjEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; [Perez kundër Francës, kërkesa nr. 47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 82). Duke qenë kështu, Gjykata nuk mund të vërë në dyshim gjetjet e gjykatave të rregullta mbi gabimet e supozuara të ligjit, përveç nëse ato janë “*arbitrare ose haptazi të paarsyeshme*” (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Scordino kundër Italisë, kërkesa nr. 36813/97](#), Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 191, dhe [Nait-Liman kundër Zvicrës kërkesa nr. 51357/07](#), Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 116). Detyra e Gjykatës në lidhje me nenin 31 është të shqyrtojë kërkesat që pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë dështuar të respektojnë “*garancictë specifike procedurale*” të përcaktuara në atë nen (Shih rastin e GJEDNJ-së, [De Tommaso kundër Italisë, kërkesa nr. 43395/09](#), Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 171). Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë arbitrariteti që në vetvete do të ngrinte çështje në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, nuk i takon Gjykatës të gjykojë nëse gjykatat e rregullta kanë zbatuar drejt një dispozitë ligjore të një ligji të caktuar.
80. Gjykata rithekson se çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit është në diskrecion dhe në gjykim të gjykatave të rregullta, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përveç nëse rezulton se ka shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çfarë është e qartë se nuk ka ndodhur në rastin nën shqyrtim.
81. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë “*zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve “*të*

pambështetura apo të paarsyetuara”, andaj Gjykata, si të tilla, në baza kushtetuese i deklaroi qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës.

82. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa në tërësinë e saj është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (b) të Rregullores së punës, më 30 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani